



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E POSAÇME E SHKALLËS SË PARË
PËR KORRUPSIONIN DHE KRIMIN E ORGANIZUAR

NR. AKTI 6
06.02.2020

NR. VENDIMI 4
28.02.2020

V E N D I M

“PËR VLEFTËSIMIN E MASËS SË SEKUESTROS”

Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korruptionin dhe Krimin e Organizuar, me trup gjykues të përbërë prej:

GJYQTAR: Bib NDRECA

Asistuar nga sekretare gjyqësore **Evalda JERA**, në dhomë këshillimi, sot me datë 28.02.2020, ora 09:00, mori në shqyrtim çështjen penale Nr. 2 Akti, datë 20.02.2020 regjistrimi, që i palëve:

KËRKUESE:

Prokuroria e Posaçme kundër Korruptionit dhe Krimit të Organizuar, prokurore e çështjes **Doloreza MUSABELLIU**.

OBJEKTI:

Vleftësimin e masës së sekuestros të vendosur me urdhërin nr. 140 datë 04.02.2020 “Për vendosjen e sekuestros në rastet e emergjencës” mbi këto pasuri të shtetasit A.D;

NDAJ PASURIVE:

- Banesë dy kate, e ndodhur në lagjen “Xxxxxx”, njësia administrative “XXXXXXXX”;
- Automjet me targa AA XXX PG, e markës “Daimler Chrysler”, viti i prodhimit 2002;
- Automjet me targa ZZ XXX XU, e llojit “Audi”, viti i prodhimit 2009;

- Motorr, me targa AC XXX, i markës “Yamaha”, viti i prodhimit 2006.

PËR SHKAK TË SUBJEKTIT:

A.D, i datëlindjes xx.xx.xxxx, me gjendje civile beqar, lindur në Tropojë, dhe banues në Shkodër, me nr. personal XXXXXXXXXXXX; i dyshuar për kryerjen e veprave penale “*Rrëmbim ose mbajtje peng e personit*”, kryer në bashkëpunim, “*Mbajtja pa leje e armëve, armëve shpërthyes dhe municionit*”, “*Trafikim i narkotikëve*”, kryer në bashkëpunim, dhe *Fshehje ose asgjësimi i kufomës*”, të parashikuara nga nenet 109/3, 278-25, 283/a-25 dhe 303 të K.Penal;

PERSONIT TË LIDHUR:

D.D, e datëlindjes xx.xx.xxxx, me gjendje civile martuar, lindur në Tropojë, dhe banuese në Shkodër, me numër personal XXXXXXXXXXXX.

BAZA LIGJORE:

Akt Normativ Nr. 1, datë 31.01.2020 “*Për masat parandaluese në kuadër të forcimit të luftës kundër terrorizmit, krimit të organizuar, krimeve të rënda dhe konsolidimit të rendit të sigurisë publike*”.

Gjykata, si u njoh me kërkesën e prokurores Doloreza Musabelliu, prokurore në Prokurorinë e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, dhe aktet e provat shoqëruese,

Vëren se:

Rrethanat proceduriale

Me shkresën nr. 900/2 Prot., datë 07.02.2020 (regjistruar në prokurori me nr. 04 Prot., datë 07.02.2020), Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, ka përcjellë materialet e sekuestrimit të pasurisë, në lidhje me shtetasin A.D, në zbatim të aktit normativ Nr.1, datë 31.01.2020 “*Për masat parandaluese në kuadër të forcimit të luftës kundër terrorizmit, krimit të organizuar, krimeve të rënda dhe konsolidimit të rendit të sigurisë publike*”.

Nga aktet rezulton se:

Policia gjyqësore ka marrë dijeni se rreth orës 11.00, të datës xx.xx.xxxx, në rrugën Londër, Kamëz, është rrëmbyer shtetasi J.P, i

cili është futur në një mjet tip “Range Rover”, me ngjyrë të bardhë.

Pas referimit të materialeve në lidhje me ngjarjen si më sipër, Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, ka regjistruar procedimin penal nr. 475 të vitit 2020, për veprën penale të “*Rrëmbimit ose mbajtjes peng të personit*”, kryer në bashkëpunim, parashikuar nga neni 109 i Kodit Penal.

Në funksion të këtij procedimi penal janë kryer një sërë veprimesh hetimore, ku, në datë 27.01.2020, në zbatim të vendimit nr. 467 datë 25.01.2020, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, është ushtruar kontroll në ambientet e kompleksit “Xxxxxx Xxxxxx”, në pronësi të shtetasit A.H, si dhe banesat e të afërmeve të tij. Si rezultat i këtyre kontrolleve janë gjetur dhe sekuestruar prova materiale që mbështesin dyshimin e arsyeshëm mbi rrëmbimin e shtetasit J.P, si dhe përsoneve të përfshirë në këtë ngjarje.

Në vijim të veprimeve hetimore, rezulton se janë ndaluar si autorë të dyshuar të ngjarjes shtetasit B.H, L.H, O.T, E.H, F.B, si dhe është bërë shpallja në kërkim e shtetasve A.H, G.F alias M/D, G.L.M , A.D, A.D, K.G.

Këta shtetas dyshohet se janë organizatorë dhe pjesëmarrës në rrëmbimin e shtetasit J.P, dhe konkretisht shtetasi A.D, i dyshuar për kryerjen e veprave penale të penale “*Rrëmbim ose mbajtje peng e personit*”, kryer në bashkëpunim, “*Mbajtja pa leje e armëve, armëve shpërthyes dhe municionit*”, “*Trafikim i narkotikëve*”, kryer në bashkëpunim, dhe *Fshehje ose asgjësimi i kufomës*”, të parashikuara nga nenet 109/3, 278-25, 283/a-25 dhe 303 të Kodit Penal;

Nga verifikimet e kryera në funksion të këtij procedimi penal, ka rezultuar se autorët e dyshuar të kësaj veprë penale, kanë në pronësi ose posedim, prona dhe asete të cilat dyshohet se mund të jenë produkt i aktivitetit kriminal në fushën e trafikimit të lëndëve narkotike dhe krimeve kundër jetës.

Sipas vendimit nr. 262/1 Akti, datë 31.01.2020, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, rezulton se ndër të tjera, ajo gjykatë ka vendosur:

“...6- *Caktimin e masës së sigurimit personal ndaj personit nën hetim A.D, atë të “arrestit në burg”, në mungesë, parashikuar nga neni 238 i K.Pr.Penale.*

- *Urdhërohet policia gjyqësore për ekzekutimin e këtij vendimi...*”.

Sipas të dhënave të përfuara nga ky vendim, rezulton se shtetasi A.D, rezulton të jetë i dyshuar për veprat penale të parashikuara nga nenet 109/3, 278-25, 283/a-25 dhe 303 të Kodit Penal.

Mbështetur në pikat 1 dhe 2, të nenit 19 të Aktit Normativ nr. 1, datë 31.01.2020, “Për masat parandaluese në kuadër të forcimit të luftës kundër terrorizmit, krimit të organizuar, krimeve të rënda dhe konsolidimit të rendit të sigurisë publike”, është sugjeruar sekuestrimi në kushtet e emergjencës të pasurive:

- Banesë dy kate, e ndodhur në lagjen “Xxxxxx”, njësia administrative “XXXXXXXX”,
- Automjet me targa AA XXX PG, e markës “Daimler Chrysler”, viti i prodhimit 2002;
- Automjet me targa ZZ XXX XU, e llojit “Audi”, viti i prodhimit 2009;
- Motorr, me targa AC XXX, i markës “Yamaha”, viti i prodhimit 2006;

pasi ka informacione dhe dyshime të arsyeshme të bazuara në elementët e faktit se këto pasuri janë siguruar në mënyrë të pajustificuar, në raport me nivelin e të ardhurave apo fitimeve nga veprimtari të ligjshme, të deklaruara sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi, si dhe, ka rrezik që pasuria të tjetërsohet, të asgjësohet, të dëmtohet e të transferohet.

Me kërkesë “Për vendosjen e sekuestros në raste emergjence”, në datë 04.02.2020, Drejtuesi i Operacionit Forca e Ligjit, i ka kërkuar Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, sekuestrimin e pasurisë së sipër shënuara.

Me Urdhër Nr. 140, datë 04.02.2020, (Nr. 900/1 Prot., datë 04.02.2020) “Për vendosjen e sekuestros të pasurive në rastet e emergjencës”, Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit, Drejtues Ardi Veliu, ka urdhëruar sekuestrimin e pasurive të mësipërme.

Me “Njoftim”, datë 04.02.2020, rezulton se nga OFL i është dërguar njoftimi mbi bërjen me dije të urdhërit të sekuestros (Nr. 140, datë 04.02.2020) shtetasit A.D. Ky i fundit nuk rezulton të ketë qenë i pranishëm, ndaj njoftimi i është komunikuar të motrës, shtetases G.J.P.

Referuar Proçesverbal-it “Për vendosjen e sekuestros në raste emergjente”, datë 04.02.2020, ora 14:45, rezulton se oficeri i OFL Almir Kalemaj, ka ekzekutuar (zbatuar) Urdhër-in Nr. 140, datë 04.02.2020 “Për vendosjen e sekuestros të pasurive në rastet e emergjencës”, të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, Drejtues Ardi Veliu, për vendosjen e

sekuestros, në prani të shtetases GJ.P (motra e shtetasit A.D).

Referuar çertifikatave personale dhe familjare, të lëshuara nga Zyrat e Gjendjes Civile Shkodër dhe Shëngjin, rezulton se shtetasi A.D është i biri i shtetases D.D si dhe ka për motër shtetasen GJ.P.

Shtetases GJ.P, motrës së subjektit të këtij akti normativ, i është marrë një “Deklaratë”, me shkrim dore, gjithsej 1 fletë, lidhur me burimet e krijimit të pasurive të sipërmshënuara.

Në “Deklaratë”, deklaruesja, ndër të tjera deklaron se: *shtëpia është ndërtuar në vitet 1994-1995, më të ardhurat e babait të saj.*

Më përpara kanë jetuar në Bajram Curri, ku kanë patur një shtëpi dy katëshe në fshatin Bllatë, D. Babai i tyre, prej moshës 20 vjeç ka punuar në shtet, në hidrocentralin e Fierzës, në Hidrocentralin e Komanit dhe në atë të Vaut të Dejës, si elektrikist i kategorisë 5, dhe ka qënë kryeplak në fshat për 6 vjet. Gjatë viteve të demokracisë, në janar të vitit 1994 janë shpërngulur nga Bajram Curri. Shtëpinë që kanë patur në Bajram Curri u’a kanë shitur për tre milionë lekë Kosovareve. Me këto të ardhura dhe me kursimet ndër vite babai ka ndërtuar shtëpinë në Shkodër.

Shtëpia nuk është e regjistruar sepse është në proces legalizimi në emër të nënës së tyre D.D. Në këtë shtëpi jeton shtetasja GJ.P me djalin dhe nënën e saj shtetasen D.D. Për katin e dytë i ka ndihmuar dhe vëllai, shtetasi N.D, pasi punon si hidraulik në Itali. Makinën i’a ka dhuruar vëllai nga Italia për ditëlindje, në datë 04.07.2019, dhe duke qënë se nuk kishte marrë akoma patentën, e ka regjistruar në emër të të vëllait A.D derisa të marrë patentën.

Nga Proçesverbal “Për kqyrjen dhe marrjen e provës materiale”, të mbajtur në datë 11.02.2020, nga oficeri i policisë gjyqësore në Drejtorinë Hetimore Qëndrore pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit Maksim Bejkaj, rezulton se sipas të dhënave të ofruara nga sistemi policor DEEPSEE, shtetasi A.D, shpallet në kërkim “Rozë”, në funksion të proçedimit penal nr. 475 viti 2020, pasi në datë 17.01.2020, në Kamëz, Tiranë, shtetasi J.P, është marrë peng nga disa persona. Nga tërësia e veprimeve hetimore të kryera rezulton se një prej autorëve të dyshuar të kësaj ngjarje është shtetasi A.D, për veprën penale “Rrëmbim ose mbajtja peng e personit e kryer në bashkëpunim”, parashikuar nga neni 109 e 25 të K.Penal.

Është kqyrrur rubrika “Punësime” dhe rezulon se ky shtetas nuk figuron i punësuar.

Është kqyrur rubrika “*Instituti i sigurimeve shoqërore, Kontributet*” dhe rezulton se ky shtetas nuk ka derdhur kontribute shoqërore.

Është kqyrur rubrika “*Subjekte në pronësi ose në administrim*”, dhe rezulton se ky shtetas nuk ka subjekte në pronësi apo administrim.

Është kqyrur rubrika “Automjete”, dhe rezulton se ky shtetas ka në pronësi dy automjete dhe një motor, dhe konkretisht automjetin me targa AA XXX PG, e markës “Daimler Chrysler”, viti i prodhimit 2002; automjetin me targa ZZ XXX XU, e llojit “Audi”, viti i prodhimit 2009 dhe motor, me targa AC XXX, i markës “Yamah”a, viti i prodhimit 2006, ngjyrë e verdhë.

Është kqyrur rubrika “*Fletë arresti*”, dhe rezulton se Gjykata e Shkallës së Parë Tiranë, me vendimin nr. 262 datë 31.01.2020, ka vendosur masën e sigurimit “*Arrest në burg*”. Përkatësisht u kqyr shënimi “*Bëhet ndryshimi i ngjyrës së kartelës nga rozë në të kuqe dhe cilësimi i veprës penale. Prokuroria Tiranë me shkresën nr. 1739 datë 05.02.2010 ka dërguar urdhërin e datës 31.01.2020 për ekzekutimin e vendimit penal nr. 262 datë 31.01.2020 të Gjykatës Tiranë, e cila ka caktuar masën e sigurimit “arrest në burg”, për veprën penale të “Rrëmbimit ose mbajtjes peng e pesonit”, kryer në bashkëpunim, “Trafikimit i narkotikëve”, kryer në bashkëpunim, “Prodhim dhe mbajtje pa leje të armëve luftarake e municionit” dhe “Fshehje dhe asgjësim i kufomës”, parashikuar nga nenet 109, 283/a, 278, 303 e 25 të Kodit Penal.”*

-Është vijuar me kqyrjen e të dhënave të shtetasës D.D, në rubrikën “*Punësime*” dhe rezulton se shtetasja D.D nuk figuron e punësuar. U kqyr rubrika “*Instituti i sigurimeve shoqërore, Kontributet*” dhe rezulton se kjo shtetase nuk ka derdhur kontribute shoqërore. Po kështu, rezulton se kjo shtetase nuk ka në administrim apo pronësi subjekte. Edhe për shtetasen G.J.P, nga kqyrja e të dhënave rezultoi që nuk është e punësuar, nuk përfiton pension, nuk ka subjekte në pronësi apo administrim, dhe ka derdhur kontribute për vitin 2013.

Me shkresën nr. 1174/1 Prot., datë 03.02.2020, të Drejtorisë Vendore Shkodër, me lëndë “*Kthim përgjigje*”, drejtuar Drejtorisë Vendore të Policisë Shkodër, në përgjigje të kërkesës nr.770/2 Prot., datë 03.02.2020, Agjensia Shtetërore e Kadastrës, ka bërë me dije se ka informacion në lidhje me përfshirje në procedurë legalizimi për shtetasen D.D. Në vijim është administruar dokumentacioni i legalizimit të banesës dy katëshe nga rezulton se procedurat e legalizimit janë bërë nga shtetasja D.D në vitin 2015 (përcjellë me shkresën nr. 1174/2 Prot., datë 04.02.2020, të Drejtorisë Vendore Shkodër).

Është administruar nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor, dosja e mjetit më targa AA XXX PG, e markës “*Daimler*

Chrysler”, viti i prodhimit 2002, nga ka rezultuar në pronësi të A.D, e blerë prej tij në datën 05.08.2019, në shumën 150.000 lekë.

Është administruar dosja e mjetit me targa ZZ XXX XU, e llojit “Audi”, viti i prodhimit 2009, e cila rezulton e blerë nga shtetasi A.D në datën 09.07.2019, në vlerën 700.000 lekë.

Është administruar dojsa e motorit me targa AC XXX, i markës “Yamaha”, viti i prodhimit 2006, nga ku rezulton se është blerë prej shtetasit A.D, në datën 28.06.2017, në vlerën 2000 euro.

Ndodhur në të tilla kushte, bazuar në gjermën b, të pikës 5, të nenit 19, të aktit normativ Nr.1 datë 31.01.2020, prokurorja, në datë 20.02.2020, i është drejtuar Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, me kërkesë (shoqëruar me shkresën përcjellëse Nr. 1561 Prot./D.M. datë 20.02.2020, të drejtuesit të prokurorisë Arben Kraja), për vleftësimin e masës së sekuestros, të vendosur me Urdhër Nr. 140, datë 04.02.2020, “Për vendosjen e sekuestros të pasurive në rastet e emergjencës”, të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, mbi pasuritë:

- *Banesë dy kate, e ndodhur në lagjen “Xxxxxx”, njësia administrative “XXXXXXXX”;*
- *Automjet me targa AA XXX PG, e markës “Daimler Chrysler”, viti i prodhimit 2002;*
- *Automjet me targa ZZ XXX XU, e llojit “Audi”, viti i prodhimit 2009;*
- *Motor, me targa AC XXX, i markës “Yamaha”, viti i prodhimit 2006.*

Në bazë të shortit elektronik, të zhvilluar në orën 08:55 të datës 21.02.2020, dokumentuar në Urdhër Nr.5 datë 21.02.2020 “Për dokumentimin e rezultateve të shortit dhe formimin e trupit gjykues”, të kryetarit të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar Sandër Simoni, kjo çështje i ra trupit gjykues të përbërë nga unë, gjyqtar Bib Ndreca.

Gjykata, duke vlerësuar kompetencën e saj për shqyrtimin e kësaj çështjeje, referuar pikës 4 të nenit 18, si dhe pikës 6 të nenit 19, të aktit normativ Nr.1 datë 31.01.2020, e shqyrtoi në dhomë këshillimi.

Aktet dhe provat

- Shkresa Nr.900/2, datë 07.02.2020, me lëndë “Dërgohen materialet e sekuestrimit të pasurisë së shtetasit M.D”, e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, i cili, i ka referuar prokurorit materialet;
- Kërkesë “Për vendosjen e sekuestros në raste emergjence”, datë 04.02.2020,

e Drejtuesit të Operacionit Forca e Ligjit, drejtuar Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit;

- Relacion *“Mbi sekuestrimin e pronave të shtetasit A.D”*, i specialistit në strukturën Operacioni Forca e Ligjit, Maksim Bejkaj;

- Urdhër Nr. 140, datë 04.02.2020, (Nr. 900/1 Prot., datë 04.02.2020), *“Për vendosjen e sekuestros të pasurive në rastet e emergjencës”*, të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, Drejtues Madhor Ardi Veliu;

- *“Njoftim”* datë 04.02.2020, i OFL drejtuar shtetasit A.D;

- Proçesverbal *“Për vendosjen e sekuestros në raste emergjente”*, datë 04.02.2020, ora 14:45, ku pasqyrohet se oficeri i OFL Almir Kalemaj, ka zbatuar Urdhër-in Nr. 140, datë 04.02.2020 *“Për vendosjen e sekuestros të pasurive në rastet e emergjencës”*, të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, Drejtues Madhor Ardi Veliu;

- Shkresa Nr. 1174/1 Prot., datë 03.02.2020, me lëndë *“Kthim përgjigje”*, e Drejtorisë Vendore Shkodër, Agjensia Shtetore e Kadastrës, drejtuar Drejtorisë Vendore të Policisë Shkodër, në përgjigje të tyre Nr.770/2 Prot., datë 03.02.2020;

- Shkresa Nr. 1174/2 Prot., datë 04.02.2020, me lëndë *“Kthim përgjigje”*, e Drejtorisë Vendore Shkodër, Agjensia Shtetore e Kadastrës, drejtuar Drejtorisë Vendore të Policisë Shkodër, vijim të shkresës Nr. 1174/1 Prot., datë 03.02.2020; shoqëruar me kopje të njëhsuar me origjinalin të praktikës nr. 11127, datë 29.01.2015;

- Shkresa Nr.148/1 Prot., datë 04.02.2020, me lëndë *“Dërgohen materialet shtesë për pasuritë e shtetasit A.D”*, e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, drejtuar Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar;

- Proçesverbal *“Për kqyrjen dhe marrjen e provës materiale”*, mbajtur në datë 11.02.2020, nga oficeri i policisë gjyqësore në Drejtorinë Hetimore Qëndrore pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit Maksim Bejkaj;

- Shkurtim vendimi *“Caktimin e masës së sigurimit personal”*, Nr. 262/1 Akti, datë 31.01.2020, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë;

- *“Çertifikatë personale”*, Mod. Nr.14, Bashkia Shkodër, për shtetasin A.D;

- *“Çertifikatë familjare”*, Mod.13, Komuna Shëngjin, për shtetasen G.J.P;

- *“Çertifikatë familjare”*, Mod.13, Bashkia Shkodër, për shtetasin A.D;

- Shkresën nr. 1094/1 Prot., datë 04.02.2020, e Drejtorisë Rajonale Tatimore Shkodër, me lëndë *“Kthim përgjigje”*, drejtuar Drejtorisë Vendore të Policisë Shkodër, në përgjigje të kërkesës nr.770/4 Prot., datë 03.02.2020;

- Deklaratë dhënë në datë 05.02.2020, nga shtetasja G.J.P;

- Kopje e Fashikullit nr. SH.D. 0533514, për dosjen e mjetit nr. AA XXX PG, marrë nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor;
- Kopje e Fashikullit nr. SH.D. 0533514, për dosjen e mjetit nr. AA XXX OL, marrë nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor;
- Kopje e Dosjes së mjetit nr. SH.D. 0256819, për mjetin nr. AC XXX, marrë nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor;
- Kopje e Dosjes së mjetit nr. KOD 0072919/SH.F. 0342319, për mjetin nr. AA XXX XU, marrë nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor; etj.

Legjislacioni i zbatueshëm.

Akt Normativ

Nr. 1, dat 31.01.2020

“Për masat parandaluese në kuadër të forcimit të luftës kundër terrorizmit, krimit të organizuar, krimeve të rënda dhe konsolidimit të rendit e sigurisë publike”

Kreu I

Të përgjithshme

Neni 5

Subjektet

2. Personat, që deri në momentin e hyrjes në fuqi të këtij akti normativ janë persona nën hetim, brenda apo jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, me përjashtim të personave për të cilët ka vendim të pushimit të akuzës apo të çështjes penale, për:

- a). pjesmarrje dhe kryerje të krimeve nga organizata kriminale, banda e armatosur dhe grupi i strukturuar kriminal, të parashikuara nga kreu XI i Kodit Penal;
- b). pjesmarrje dhe kryerje të krimeve nga organizata terroriste e të krimeve për qëllime terrosiste, parashikuar nga kreu VII i Kodit Penal;
- c). kryerjen e krimeve të parashikuara në nenet 77, 78, 78/a, 79, 79/a, 79/b, **109**, 109/b, 110/a, 114, 117, 128/b, 134, paragrafi i tret, 136, 138/a, 139, 140, 141, 151, 152, 278/a, 282/a, 283, **283/a**, 284 dhe 284/a, t Kodit Penal;

Kreu II

Masat parandaluese personale

Neni 16
Subjektet

Dispozitat e këtij kreu për masat parandaluese me karakter pasuror do të zbatohen:

a). për subjektet e përmendura në nenin 5;...

c). ndaj pasurive të personave të parashikuar në nenin 5, të ktij akti normativ, në pronësi ose të zotëruara në mënyrë të tërthortë nga:

i personat e afërm (bashkëshortët, fëmijët, të paralindurit, të paslindurit, vëllezërit dhe motrat, bashkëjetuesit për periudhën e 5 viteve të fundit), **për të cilët prezumohet regjistrimi i rremë, përveçse kur provohet e kundërta;**

ii personat fizikë ose juridikë, për të cilët ka të dhëna të mjaftueshme se pasuritë ose veprimtaritë e tyre zotërohen, pjesërisht ose plotësisht, në mënyrë të tërthortë nga personat e parashikuar në nenin 5, si subjekte të këtij akti normativ, ose janë përdorur, kanë lehtësuar apo kanë ndikuar në një formë të caktuar në kryerjen e veprimtarive të jashtëligjshme prej tyre.

Neni 19

Sekuestrimi i pasurisë nga Policia e Shtetit në rastet e emergjencës

1. N rastet e nevojës dhe të urgjencës kur ka informacione apo dyshime të arsyeshme, të bazuara në elemente të faktit se pasuritë e subjekteve të parashikuara në nenin 16 të këtij akti, pavarësisht nëse zotërohen apo janë në përdorim apo posedim në mënyrë të drejtprdrejtë ose të tërthortë prej tyre, janë siguruar në mënyrë të pajustificuar në raport me nivelin e të ardhurave apo fitimeve nga veprimtari të ligjshme, të deklaruar sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi, si dhe kur pasuria ka rrezik të tjetërsohet, të asgjësohet, të dëmtohet, të transferohet, të transportohet apo në çdo rast tjetër që dyshohet se mund të rrezikohet zbatimi i një mase të mundshme sekuestroje, drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit urdhëron vendosjen e masës së sekuestros.

.....

5. Brenda 15 ditëve nga paraqitja e kërkesës nga ana e drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, prokurori me vendim të motivuar:

.....

b) paraqet kërkesën për vleftësimin e masës së sekuestros në gjykatën kompetente sipas parashikimit të ktij akti normativ. Mosrespektimi i afatit për paraqitjen e kërkesës në gjykatë nuk pezullon zbatimin e masës parandaluese.

6. Gjykata, shprehet me vendim për vleftësimin e masës së sekuestros

brënda 15 ditëve nga paraqitja e kërkesës së prokurorit kompetent sipas parashikimeve të këtij akti normativ. Nëse gjykata nuk shprehet brënda këtij afati masa e sekuestros mbetet në fuqi...

Arsyetimi i gjykatës

Gjykata, në vlerësim të akteve të sipër shënuara, konstaton se plotësohen kërkesat e parashikuara nga aktin normativ Nr. 1, datë 31.01.2020.

Shtetasi A.D, po hetohet për veprat penale “Rrëmbim ose mbajtje peng e personit”, kryer në bashkëpunim, “Mbajtja pa leje e armëve, armëve shpërthyes dhe municionit”, “Trafikim i narkotikëve”, kryer në bashkëpunim, dhe *Fshehje ose asgjësimi i kufomës*”, të parashikuara nga nenet 109/3, 278-25, 283/a-25 dhe 303 të Kodit Penal; ndaj, referuar nenit 5 dhe 16, gërmat a, të aktit normativ Nr. 1, datë 31.01.2020, është subjekt i këtij akti normativ.

Shtetasja D.D është person i afërt (e ëma) me personin nën hetim A.D, ndaj edhe kjo shtetase, referuar nenit 5 dhe 16, gërmat a, të aktit normativ Nr. 1, datë 31.01.2020, është subjekt i këtij akti normativ.

Me Urdhër Nr. 140, datë 04.02.2020, “Për vendosjen e sekuestros të pasurive në rastet e emergjencës”, Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit, Drejtues Ardi Veliu, ka urdhëruar sekuestrimin e pasurive:

“- Banesë dy kate, e ndodhur në lagjen “Xxxxxx”, njësia administrative “XXXXXXXX”.

- Automjet me targa AA XXX PG, e markës “Daimler Chrysler”, viti i prodhimit 2002;

- Automjet me targa ZZ XXX XU, e llojit “Audi”, viti i prodhimit 2009;

- Motorr, me targa AC XXX, i markës “Yamaha”, viti i prodhimit 2006.”

Gjykata vlerëson se, Urdhëri Nr. 140, dat 04.02.2020, “Për vendosjen e sekuestros të pasurive në rastet e emergjencës”, i Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, Drejtues Madhor Ardi Veliu, është dhënë në përputhje me pikat 1 dhe 2, të nenit 19, të aktit normativ Nr. 1, dat 31.01.2020.

Ky urdhër për sekuestrim rezulton t’i jetë njoftuar të afërmve të subjektit (të motrës, shtetases G.J.P).

Në respektim të pikës 4, të nenit 19, të aktit normativ, me shkresën Nr.900/2, datë 07.02.2020, me lëndë “Dërgohen materialet e sekuestrimit të

pasurisë së shtetasit A.D”, Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit i ka referuar Prokurorisë së Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar materialet, dhe i ka kërkuar vleftësimin e masës së sekuestros.

Në mbështetje të gërmës b, të pikës 5, të aktit normativ nr. 1 datë 31.01.2020, prokurorja, brenda afatit ligjor 15 ditor, paraqiti kërkesën në gjykatë për vleftësimin e masës së sekuestros mbi pasuritë e sipër shënuara.

Pasuria e sekuestruar, banesë dy kate, e ndodhur në lagjen “XXXXXX”, njësia administrative “XXXXXXXX”, rezulton të jetë përfshirë në procedura legalizimi, nga ana e nënës së shtetasit A.D, nga shtetësja D.D.

Veprat penale për të cilat rezulton të jetë nën hetim shtetasi A.D janë vepra që janë objekt i aktit normativ dhe që kryhen edhe me qëllime përfitimi të paligjshëm, duke krijuar në vijimësi pasuri, nga burime të paligjshme.

Duke vlerësuar edhe shpjegimet e dhëna nga shtetësja G.J.P në deklaratën e lëshuar prej saj, gjykata, vlerëson se pasuria (banesa) e përfshirë në proces legalizimi, nuk rezulton të justifikohet deri në këtë moment me të ardhura të ligjshme.

Po ashtu, edhe dy automjetet dhe motori, në pronësi të shtetasit A.D, nuk rezulton të justifikohet me të ardhura të ligjshme.

Në referim të provave të shqyrtuara, gjykata vlerëson se ekziston një rrezik real për të kryer veprime për tjetërsimin e pasurive mbi të cilat është vendosur sekuestro (kriteri i veçantë i parashikuar pika “1” nenit 19), me qëllim shkaktimin e pamundësisë për të zbatuar masat parandaluese të parashikuara në aktin normativ. Shtetasi A.D, duke qenë person nën hetim për llogari të procedimit penal nr. 475 të vitit 2020, regjistruar në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Tiranë, mbi të cilën është vendosur edhe masa e sigurimit “*arrest në burg*”, mund të bëjë përpjekje për tjetërsimin e pasurive me qëllim shmangien nga një konfiskim i mundshëm.

Për sa më sipër, Gjukata vlerëson se deri në këtë fazë të hetimit, nga aktet e paraqitura nga organi i akuzës, ka dyshime të arsyeshme se për personin nën hetim A.D, evidentohen në posedim pasuri të cilat dyshohet se nuk justifikohen me të ardhurat e ligjshme të subjektit, për këtë arsye kërkesa e paraqitur për vleftësimin e sekuestrimit të pasurisë vlerësohet e bazuar. Pas kësaj faze, gjykata vlerëson se personi i dyshuar ka barrën e provës, për të justifikuar origjinën e ligjshme të pasurive të tij, për

të argumentuar mungesën e lidhjes së pasurisë me cilësimin si produkte të veprës penale ose investim të tyre.

Për këto arsye

Gjykata, bazuar në pikën 6, të nenit 19, të Aktit Normativ nr. 1, dat 31.01.2020, “Për masat parandaluese në kuadër të forcimit të luftës kundër terrorizmit, krimit të organizuar, krimeve të rënda dhe konsolidimit të rendit të sigurisë publike”,

VENDOS:

- Vleftësimin e masës së sekuestros, të vendosur me Urdhër Nr. 140, datë 04.02.2020, “Për vendosjen e sekuestros të pasurive në rastet e emergjencës”, të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, mbi pasuritë:
 - Banesë dy kate, e ndodhur në lagjen “Xxxxxx”, njësia administrative “XXXXXXXX”;
 - Automjet me targa AA XXX PG, e markës “Daimler Chrysler”, viti i prodhimit 2002;
 - Automjet me targa ZZ XXX XU, e llojit “Audi”, viti i prodhimit 2009;
 - Motorr, me targa AC XXX, i markës “Yamaha”, viti i prodhimit 2006.
- Sekuestrim i pasurive të mësipërme për një periudhë 4 mujore, duke filluar ky afat nga momenti i zbatimit të masës së sekuestros.
- Caktimin e Agjensisë së Administrimit të Pasurive të Sekuestruara e të Konfiskuara, për marrjen në administrim të pasurive të sekuestruara.
- Urdhërohet sekretaria gjyqësore që të njoftojë dhe të vërë në dispozicion një kopje të vendimit shtetasve **A.D dhe D.D**, Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit dhe Agjensisë së Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të

Konfiskuara.

- Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, brënda 15 ditëve nga marrja dijeni apo njoftimi i vendimit.

- U shpall në Tiranë, sot më datë 28.02.2020.

SEKRETARE

GJYQTARE

EVALDA JERA

BIB NDRECA

